Përgatisni Çdo Gjë të Nevojshme

DEPOZITIME FAMILJARE NË SHTËPI

MESAZH NGA PRESIDENCIA E PARË

Të Dashur Vëllezer dhe Motra:

Ati ynë Qiellor e krijoi këtë tokë të mrekullueshme, me të gjithë bollëkun e saj, që të fitojmë dhe ta shfrytëzojmë. Qëllimi i tij është të sigurojë për nevojat tona kur ne ecim me besim dhe bindje. Ai na ka urdhëruar me dashuri të "përgatisni çdo gjë të nevojshme" (shih DeB 109:8) kështu që, nëse ndodh një fatkeqësi, ne mund të kujdesemi për veten dhe për fqinjët tanë dhe të mbështesim peshkopët ndërsa ata kujdesen për të tjerët.

Ne nxitim anëtarët e Kishës në mbarë botën të përgatiten për kohë fatkeqësie në jetë duke patur një furnizim bazë ushqimi e uji dhe disa para të kursyera.

Ne ju kërkojmë të jeni të urtë kur depozitoni ushqim dhe ujë dhe krijoni kursimet tuaja. Mos shkoni në ekstreme, nuk është urtësi, për shembull, të hysh në borxh për të krijuar menjëherë rezervën tënde ushqimore. Me planifikim të kujdesshëm, ju mundeni, gjatë kohës, të krijoni një rezervë furnizimi në shtëpi dhe një rezervë financiare.

Ne e kuptojmë se disa nga ju nuk mund të kenë burime financiare apo vend për të tillë rezervë. Disa nga ju mund ta keni të ndaluar nga ligji të depozitoni sasi të mëdha ushqimore. Ne ju nxisim të depozitoni aq sa e lejojnë rrethanat.

Zoti ju bekoftë në përpjekjet tuaja për depozitime shtëpie.

Presidencia e Parë

FURNIZIM TRE-MUJOR

Krijoni një sasi të vogël furnizimi ushqimor që është pjesë e dietës tuaj normale ditore. Një mënyrë për ta bërë këtë është të blesh disa artikuj tepër çdo javë për të krijuar një rezervë ushqimore një javore. Pastaj ju mund të rritni pak nga pak furnizimin tuaj deri sa të jetë i mjaftueshëm për tre muaj. Këta artikuj duhet të ciklohen rregullisht për të shmangur prishjen.

UJË I PIJSHËM

Depozitoni ujë të pijshëm për raste kur furnizimi me ujë mund të jetë ndotur ose ndërprerë.

Nëse uji vjen direkt nga një burim i mirë i përpunuar më parë, atëhere nuk nevojitet pastrim tjetër, ndryshe përpunojeni ujin para përdorimit. Ruajeni ujin në konteinerë të fortë, që nuk rrjedhin dhe nuk thyhen. Mendoni të përdorni shishe plastike të zakonshme të lëngjeve të frutave dhe freskueseve.

Mbajini konteinerët e ujit larg nga burimet e nxehtësisë dhe nga drita direkte e diellit.

REZERVA FINANCIARE

Krijoni një rezervë financiare duke kursyer pak para çdo javë dhe pak nga pak duke e rritur atë në një shumë të arsyeshme (shih *Përgatisni Çdo Gjë të Nevojshme:* udhëzues *i Financave Familjare*).

FURNIZIME MË AFATGJATA

Për nevoja më afatgjata dhe atje ku është e lejueshme, pak nga pak krijoni një rezervë furnizimi ushqimor që do të zgjasë një kohë të gjatë dhe që ju mund ta përdorni për të jetuar, të tilla si grurë, oriz të bardhë dhe fasule.

Këta artikuj mund të ruhen deri në 30 vite ose më shumë kur paketohen mirë dhe ruhen në vend të freskët dhe të thatë. Një porcion nga këta artikuj mund të ciklohet në furnizimin tuaj tre mujor.

"Organizoni veten tuaj; përgatisni çdo gjë të nevojshme dhe ngrini një shtëpi, madje një shtëpi lutjeje, një shtëpi agjërimi, një shtëpi besimi, një shtëpi mësimi, një shtëpi lavdie, një shtëpi rregulli, një shtëpi të Perëndisë."

(DeB 109:8).

Shihni në Internet
www.providentliving.org
për më shumë informacion mbi
depozitat e shtëpisë.

KISHA E
JEZU KRISHTIT
E SHENJTORËVE TË
DITËVE TË MËVONSHME

© 2007 by Intellectual Reserve, Inc.
Të gjitha të drejtat rezervohen.
Printed in Germany
Miratimi në anglisht: 3/07
Miratimi për përkthim: 3/07

ALBANIAN
4 02040 08101 6
04008 101